



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:116477
Datë: 22.05.2022
Numri i dokumentit: 03038615

C.nr.819/2021

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit F.H. nga Gj., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fadil Sinanaj, avokat në Gjilan, kundër të paditurës SHSKUK në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson V.R., me objekt kontesti pagesën e shpërblimit jubilar, dhe vlera e kontestit 448.06 €, pas shqyrtimit kryesore publike të mbajtur, në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarës së të paditurës, më datë 13 maj 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesë padia e paditësit F.H nga Gj., ashtu që DETYROHET e paditura, SHSKUK në Gjakovë që paditësit F.H. nga Gj., në emër të shpërblimit jubilar t'ia paguaj vlerën e një page bazë, dhe atë shumën prej 377.00 € së bashku me kamatën ligjore në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 10.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 199,00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara, dhe atë në emër të kompensimit të një page jubilarë t'ia paguaj shumën prej 71.06 €.

A r s y e t i m

Paditësi F.H., nga Gj., pranë kësaj gjykate, me datë 10.06.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës, SHSKUK në Gjakovë me objekt kompensimin e shpërblimit jubilar. I autorizuari i paditësit në padinë e parashtruar, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë të çështjes dhe në fjalën e tij përfundimtare, ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, i njëjti te e paditura i ka 10 vite të përvojës në punë si dhe nga lista e pagës vërtetohet se paditësi pagën mujore e ka në shumë prej 448.06 euro. Tutje ka shtuar se e kundërshton pretendimin e përfaqësueses së të paditurës sa i përket mosparaqitjes së kërkesës në procedurë administrative për pagesën e shpërblimit jubilar, duke theksuar se tani jemi në procedure kontestimore dhe se kërkesat në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës, parashkruhen në afat prej 3 viteve, me ç 'rast ky

nen nuk e parasheh askund që fillimisht të bëhet kërkesa në procedurë administrative dhe se në si paditës nëse pajtohet edhe pala e paditur ndihemi të gatshëm që të lidhim ujdë gjyqësore ku pala e paditur do të detyrohej që paditësit të i'a paguaj shpërblimin jubilar dhe ne do të heqim dorë nga kamata ligjore, gjithashtu edhe nga shpenzimet e procedurës. Po ashtu ka deklaruar se e kundërshton në tërësi deklarin e përfaqësueses së të paditurës, sa i përket shujtës dhe kujdestarisë, për shkak se emërtimin e ka shujtë dhe kujdestari ndërsa në realitet është shtesë në pagë, e cila shtesë është e rregulluar që nga viti 2007 e deri më sot. Andaj në bazë të Ligjit për financa cdo e hyrë e punëmarrësit nga punëdhënësi i njëjti, brenda periudhës një mujore, konsiderohet pagë mujore, ku këtë definicion e ka specifikuar edhe kontrata kolektive sektoriale e shëndetësisë, andaj me të drejtë paditësi pagën mujore e ka në vlerë prej 448.06 euro, kjo pasi që nga paga e cila figuron në listën e pagës në vlerë prej 548.06 euro, është zbritur shtesa në emër të Covid-it, përkatësisht vlera prej 100. Mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadija e paditësit të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditur, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar të ia paguaj shumën prej në shumën prej 3448,06 euro, në vlerë të një page mujore dhe atë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive për shkak se i padituri i ka 10 vite përvojë pune.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe të njëjta i ka specifikuar dhe atë: në emër të taksës gjyqësore për padi shumë në vlerë prej 20,00€, në emër të përpilimit të padisë shumë në vlerë prej 78,00€ dhe në emër të pjesëmarrjes në një seancë gjyqësore shumë në vlerë prej 101,00€.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës në përgjigjen në padi, seancën gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit. Ka shtuar se pagesa e shpërblimit jubilar nuk i është bërë në mungesë të mjeteve buxhetore, pasi që Ministria e Financave nuk ka paraparë vijë buxhetore për këtë kategori dhe ndarje buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Duke theksuar se paditësi nuk ka bërë kërkesë me shkrim në spital për pagesën e shpërblimit jubilar, dhe të marr përgjigje brenda afatit të pëcaktuar ligjor, dhe në këtë mënyrë nuk janë plotësuar kushtet e mjeteve të brendshme. Më tutje e njëjta e ka kundërshtuar edhe lartësinë e vlerës së kontestit pasi që në të është përfshirë edhe shujta si shtesë në pagë, ndërsa sa i përket shtesës së emergjencës për Covid, e njëjta është zbritur nga i autorizuari i paditësit në rastin e paraqitjes së padisë. Për këto arsye, e njëjta i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit t'a refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, të mbajtur me datën 13.05.2020, gjykata bëri administrimin e provave, si: Kontratat e punës për paditësin F.H. me Nr. Prot, 3457 e datës 31.12.2012, Vërtetimi i marrëdhënies së punës i dt.07.06.2021 i lëshuar Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – SHSKUK, Lista e pagave për paditësin e dt. 27.05.2021.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se padia e paditësit është e bazuar pjesërisht dhe si e tillë u miratua.

Nga Kontratat e punës për paditësin F.H. me Nr. Prot, 3457 e datës 31.12.2012 e lidhur në mes të këtu të paditurës SHSKUK-së dhe F.H. këtu paditës gjykata vërtetoi faktin se i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura me detyrë ‘*Teknik i Ekonomisë, Insenerator*’ që nga data 31.12.2012.

Nga Vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 07.06.2021, u vërtetua fakti se i njëjti është i punësuar në SHSKUK në Gjakovë si ‘*Teknik i Ekonomisë, Insenerator*’ prej datës 09.11.2011 dhe se i njëjti i ka 10 vite përvojë pune.

Nga Lista e pagës e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e dt. 27.05.2021 u vërtetua se paditësi ka pagën mujore në vlerë prej 377.00 Euro.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj), dhe me neni 4 paragrafi 1 i KKS përcakton se: “*KKS-ja gjen zbatim për rregullimin e raporteve juridike për të gjithë të punësuarit nëpër institucione shëndetësore, duke përfshirë tri nivele të sistemit shëndetësor, atë parësor, dytësor dhe tretësor*”, dhe par.2 i këtij neni ka përcaktuar që “*Fushat e zbatimit të KKS-së ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativë në institucione shëndetësore*”, ndërsa me nenin 3 par.1 nën par. 1.7. të po të njëjtës është paraparë se “*Punëtorë të Administratës- janë punëmarrësit nga shërbimet administrative si dhe shërbimet mbështetëse, mirëmbajtëse të institucioneve shëndetësore*”.

Me nenin 17 par. 3 pika 3.1, të KKS parashihet se “*Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë [...] Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij*”, ndërsa par. 4 i këtij neni parashihet se “*Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara dhe të elaboruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi tek e paditura i ka 10 vite përvojë pune, fakt ky i provuar nga vërtetimi i marrëdhënies së punës i datës 07.06.2021, i lëshuar nga e paditura, dhe rrjedhimisht i njëjti i ka plotësuar kushtet e parapare me nenin 17 par. 3 pika 3.1 të KKS, për të qenë përfitues i shpërblimi jubilar në vlerë të 1 (një) page bazë, mirëpo të njëjtit nuk i është paguar nga ana e të paditurës. Lartësinë e pagesë bazë në shumë prej 377.00 €, gjykata e vërtetoi sipas listës së pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditësit F.H. Për faktin se paditësi është në marrëdhënie pune, duke punuar tek e paditura, dhe rrjedh se si punëdhënës i fundit për të njëjtin ka qenë SHSKUK, në Gjakovë.

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, i njëjti është i legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e

paditura, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën si në dispozita të aktgjykimit.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka linjë buxhetore të ndarë për pagesën e pagave jubilarë i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton KKSSH, kurse mungesa e buxhetit të të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me nenin 55 par. 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, parasheh se “*i punësuarit ka të drejtë për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuarit i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës*”. Në anën tjetër, neni 17 par. 3 pika 3.1 i KKS-së, thotë i punësuarit ka të drejtë në realizimit të një page mujore, e që nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga. Pra ky përcaktim ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë, dhe shtesa nga paga. Mbi këtë bazë gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht shumën në lartësi prej 71.06 €, pasi që gjykata e vlerësoi se paditësit i takon një pagë bazë e parapara si në listën e pagave, dhe jo duke përfshirë shtesat që i ka pranuar nga e paditura (siç janë: shujta dhe kujdestaria). Kjo për faktin se shtesat tjera nga paga, duke përfshirë bonuset etj., të punësuarit i takojnë kur ai gjatë angazhimit në detyra të punës arrin të realizoj shtesat në ushqim, punë jashtë orari, etj.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarës së të paditurës, por gjeti se të njëjtat në këtë çështje juridike kontestimore nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe, nga ajo që ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditësit i’u pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 199.00 €. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00€ (e parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 78,00€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësit në një seancë, shuma në vlerë prej 101,00€ (të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, në përputhje me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.819/2021 datë 13 maj 2022 .

G j y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.